

Sharrcem Faktet

LAB – Hani I Elezit, pika e shitjes së të vjelurave të frutave

Gjatë tremujorit të pare, LAB ka grumbulluar të dhëna nga 5 sera. Nga gjithsejtë 3 sera aktive. Janë mbjellë 12,000 bimë të sallatës së gjelbër të llojit Lirica dhe 7 mijë sosh tashmë janë vjelur. Ë dhënat nga shitja janë ofruar drejtpërsëdrejti nga fermerët e LAB.



Shitjet e para ishin realizuar në fillimi të muajit Mars. Në bazë të informacioneve të marra nga përfituesi Z. Sadam Dernjani më shumë se 100 copë u janë shitur disa restoranteve të cilat gjenden përgjatë rrugës kryesore Hani i Elezit – Ferizaj, si dhe qendrës më të madhe tregtare në Ferizaj dhe Prishtinë ETC dhe Hotelit Sirius.



Projekti LAB ka filluar të jap rezultate, prandaj menjëherë duhet të përfshihet për ta aktivizuar piken e shitjes. Ne në bashkëpunim me Komunën kemi arritur ta gjejmë një lokaciona ku mund ta ndërtojmë një pike të shitjes me 50 m², lokaciona është në afërsi të rrugës kryesore. Sharrcemi e konsideron këtë projekt si shumë të rëndësishëm

për komunitetin, prandaj neve kemi ofruar mbështetje në çdo kohë me burimet tona që i kishim në dispozicion, me ekipin më të mire teknik dhe financiar.

Faza e pare arkitektonike e projektit ishte mbuluar nga burimet e tona me dy arkitekt. Ndërtimi pjesës së jashtme i është dhënë një kompanie nga Ferizaji e cila i ka kryer të gjitha punët e domosdoshme për këtë faze. Brendësia e objektit është kontraktuar që të kryhet nga një kompani lokale.

Temperaturat e ftohta në pjesën e fundit të muajit Prill e kanë vonuar prodhimin e dredhëzave për disa javë. Pori a ka vlejtur të pritëshin këtë dredhëza. Këtë fruta të prodhuara nga përfituesit tonë në Han të Elezit kanë filluar të vilen në mes të muajit Maj. Pastaj poashtu ka filluar edhe shitja e trangujve nëpër shitore për përdorim të freskët. Shitja e prodhimeve ka filluar me dredhëzat (fruta të hershme) dhe me tranguj. Prodhimi i serave ka ofruar edhe fidane cilësore për mbjelljet e produkteve në fushë të hapur në fazën e hershme të kësaj sezone. Serat kërkojnë punë më intensive por edhe gjenerojnë kapital më intensiv sesa mbjelljet në fushë të hapur dhe përfaqësojnë një burim të rëndësishëm të të ardhurave për shumë fermer të specializuar, Domatet janë perimet më të zakonshme që kultivohen në sera të përcjella nga trangujt. Zhvillimi i kultivimit të perimeve në sera deri më tani bimët janë të zhvilluara mire dhe kanë kushte dhe shëndet të mire.



Papunësia ende mbetet një ndër problemet më të mëdha për shumicën e banorëve të Hanit të Elezit, e posaçërisht për fermerët në pjesët rurale. Pasiqë sektori agro-malor mbetet sektori më premtues për zhvillim dhe krijim të vendeve të punës në Kosovë, përfshirja e LAB do të vazhdojë edhe gjatë vitit 2015 për ti mbështetur sektorët potencial të agro-bizneseve që do të lehtësonin dhe gjeneronin të hyra dhe vende të reja pune.

SHARRCEM

a  TITAN Group Company



Group Corporate Values



INTEGRITY



KNOW-HOW

VALUE TO CUSTOMER



DELIVERING RESULTS

CONTINUOUS SELF-IMPROVEMENT



CORPORATE SOCIAL RESPONSIBILITY